

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË KRIJIMIN E HENDEKUT GJINOR NË PUNËT SHTËPIAKE TEK FËMIJËT RASTI I SHQIPËRISË

PRANVERA ELEZI, INSTITUTI I STATISTIKAVE
pelezi@instat.gov.al

Abstrakti

Ky artikull eksploron formimin e roleve gjinore lidhur me ndarjen e punës së papaguar. Ndryshe nga studimet e deritanishme mbi përdorimin e kohës, në fokus të studimit janë fëmijët e moshës 10-17 vjeç.

Modeli i familjes në kulturën shqiptare, ka një bërthamë familjare që përbëhet nga prindërit dhe fëmijët e tyre. Sipas të dhënave të censurit të vitit 2011, një në dhjetë familje në Shqipëri janë të përbëra nga dy ose më shumë bërthama familjare. Çështja nëse prania e gjyshërve në shtëpi ndikon në formimin e roleve gjinore tek nipërit/mbesat e tyre, lidhur me punën e papaguar, është shumë e debatuar, duke vënë theksin më së shumti në transmetimin ndër breza të roleve gjinore. Duke përdorur të dhënat e Anketës së Përdorimit të Kohës në Shqipëri, të kryer në vitet 2010-2011, është vlerësuar një model regresioni logit për të analizuar faktorët përcaktues të pjesëmarrjes së fëmijëve në punët shtëpiake. Gjetjet e studimit dëshmojnë për një formim të roleve gjinore në ndarjen e punës së papaguar që në moshë të hershme

tek fëmijët. Duke analizuar ndarjen gjinore të punëve shtëpiake tek fëmijët, sipas përbërjes së njësisë ekonomike familjare, rezultojnë që megjithëse prania e gjyshërve në familje nxit një pjesëmarrje më të balancuar të djemve dhe vajzave në aktivitete të punës së papaguar, hendeku gjinor mbetet përsëri larg të qenit të barabartë dhe është shumë i anuar drejt përcaktimit të punëve shtëpiake, si detyrë që u takon vajzave. Rezultatet konfirmojnë që koha dedikuar punëve shtëpiake rritet si për vajzat, ashtu dhe për djemtë të cilët jetojnë në shtëpi bashkë me gjyshërit e tyre. Ngarkesa e punës së papaguar është akoma më e madhe për vajzat që jetojnë në familje ku është i pranishëm vetëm njëri nga gjyshërit.

FJALË KYÇE:

Përdorimi i kohës; Rolet gjinore; Puna e papaguar; Hendeku gjinor; Bërthamë familjare; Fëmijë

1. HYRJJE

Çështja e ndarjes gjinore të punës së paguar dhe të papaguar, mes grave dhe burrave, dhe mes vajzave e djemve, është nga më të diskutuarat në shkencat sociale dhe në ekonomiksin gjinor (Bianchi, et al., 2006; Olah dhe Gähler, 2014, etj.). Barazia gjinore është themeli i politikave të zhvillimit dhe strategjive kombëtare e ndërkombëtare, ku objektivi që theksohet më së shumti, lidhet me ngushtimin e hendekut gjinor të përcaktuar në treguesit e synuar si, për shembull hendeku gjinor në paga, hendeku gjinor në pjesëmarrjen në forcat e punës dhe hendeku gjinor në arsim (Alvares dhe Miles, 2008). Edhe pse statistikat konfirmojnë për një progres pozitiv në ngushtimin e hendekut gjinor, nuk mund të thuhet e njëjta gjë sa i përket ndarjes së roleve gjinore në aktivitetet e përditshme brenda shtëpisë. Gratë në shoqërinë shqiptare, ashtu si dhe në shumë shoqëri të tjera, konsiderohen si shtylla e shtëpisë, duke mbajtur shtëpinë dhe kujdesur për fëmijët e tyre, duke u kujdesur për më të moshuarit në familje, madje duke u kujdesur edhe për partnerin/bashkëshortin e tyre (Elezi, 2017).

Studimi mbi përdorimin e kohës në Shqipëri, i kryer gjatë viteve 2010-2011, konfirmoi qartazi, për herë të parë në terma sasiorë, ndarjen e roleve gjinore sa i përket punës së paguar dhe të papaguar. Burrat konsiderohen si shtyllat financiare që mbajnë familjen, duke siguruar të ardhurat për familjet e tyre (thënë ndryshe shtylla e familjes), ndërsa gratë duhet të merren me punët shtëpiake dhe të kujdesen për fëmijët e tyre, edhe nëse janë të punësuar dhe sigurojnë të ardhura për familjen e tyre. Për ndarjen e roleve gjinore, që lidhen me punën e papaguar, janë kryer kërkime shkencore të shumta, duke u fokusuar kryesisht në analizën se kush bën çfarë në shtëpi (Fernandez dhe Sevilla-Sanz, 2006). Por ka disa çështje interesante dhe relevante që duhet të adresohen, të cilat lidhen me ndarjen e punës së papaguar brenda familjeve të kompozuar nga dy ose më shumë bërthama familjare. Ky artikull përqendrohet në çështjen e krijimit dhe moskrijimit të hendekut gjinor në punën e papaguar mes fëmijëve të moshës 10-17 vjeç që jetojnë së bashku me prindërit e tyre (të dy prindërit ose me njërin prej tyre) dhe me të paktën njërin nga gjyshërit ose me të dy. Artikulli ka si qëllim të adresojë fortësinë e korrelacioneve mes roleve gjinore dhe transmetimit nga brezi në brez të roleve gjinore, duke kontrolluar statusin e punësimit të prindërve dhe përbërjen e familjes. Një nga hipotezat e këtij studimi është ndikimi i pranisë së gjyshërve në zbutjen e ndarjes gjinore të punës së papaguar mes nipërve dhe mbesave të tyre. Alvares dhe Miles (2008) studiuhan hipotezën e

transmetimit të roleve gjinore, duke u fokusuar në mënyrën se si fëmijët riprodhojnë rolet e prindërve të tyre në shtëpi. Ky studim ndryshon nga analizat e mëparshme empirike për ndarjen e roleve gjinore lidhur me punën e papaguar pasi bazohet në informacionin për fëmijët në vend të informacionit për moshat e rritura. Këtu, analizës së hendekut gjinor në përdorimin e kohës, i është shtuar dhe një aspekt tjetër që ka të bëjë me bërthamën e familjes.

Për analizën empirike të paraqitur në këtë artikull janë përdorur të dhënat e Anketës së Përdorimit të Kohës. Në secilën nga familjet e zgjedhura për anketën janë intervistuar të gjithë individët e moshës 10 vjeç e lart, të cilët plotësuan gjithashtu dy ditarë ku regjistruan të gjitha aktivitetet e kryera gjatë 24 orëve të ditës së zgjedhur. Njëri ditar u plotësua për një ditë jave dhe ditari i dytë për një nga ditët e fundjavës.

Të dhënat e Anketës së Përdorimit të Kohës (APK) mundësojnë lidhjen e të dhënave të prindërve me të dhënat e fëmijëve, gjë që është shumë e rëndësishme për të analizuar lidhjet mes brezave. Seksioni i dytë i këtij artikulli ofron një rishikim të shkurtër të literaturës mbi formimin dhe transmetimin e roleve gjinore brenda familjes. Ndërkohë, seksioni i tretë paraqet një përshkrim se si përdorimi i kohës i jep formë ndarjes së rolit gjinor që në moshat më të reja. Seksioni i katërt paraqet specifikimin e modelit ekonometrik dhe pasohet nga seksioni i pestë që përmban rezultatet e analizës empirike. Seksioni i fundit i artikullit përmban gjetjet kryesore që rrjedhin nga analiza empirike.

2. RISHIKIM I LITERATURËS

Shoqëria shqiptare karakterizohet nga lidhjet e forta familjare (Bajraba, 2014), prandaj procesi i transmetimit të besimeve dhe qëndrimeve nga prindërit tek fëmijët e tyre bëhet më i lehtë. Alesina dhe Guiliano (2007) thonë që lidhjet e forta familjare nënkuptojnë një ndarje më strikte të punës, ku burrat punojnë në treg dhe gratë punojnë në shtëpi dhe kryejnë një sërë shërbimesh, me gjasë ruajtjen e një lidhjeje të fortë familjare. Rolet gjinore formohen që në fillimet e jetës nëpërmjet ndërveprimit me mjedisin e tyre.

Duke përdorur të dhënat e Anketës së Përdorimit të Kohës në Spanjë, Alvares dhe Miles (2008) gjetën një korrelacion të fortë dhe të rëndësishëm mes përfshirjes së baballarëve dhe djemve të tyre në punët shtëpiake. Ata argumentojnë se politikat që kanë për qëllim të krijojnë barazi në rolet gjinore mes prindërve, mund të kenë ndikim pozitiv në periudha afatgjata për fëmijët.

Alvares dhe Miles (2008) theksojnë se sfida më e

madhe për vlerësimin e efektit rastësor të roleve gjinore të prindërve mbi rolet gjinore të fëmijëve, e matur nëpërmjet punëve shtëpiake, është endogjeniteti i sjelljes së babait, për arsye se ajo shkakton shmangie të efektit të vlerësuar. Ata argumentojnë se është akoma më e vështirë që të izolohet ndikimi i babait (transmetimi vertikal) nga ndikimi i shoqërisë (transmetimi indirekt), pasi vetë shoqëria mund të ndikojë rolet gjinore tek baballarët.

Cosp dhe Roman (2014) studiovan transmetimin e roleve gjinore nga prindërit tek fëmijët në Spanjë, duke analizuar efektin e karakteristikave të prindërve në masën në të cilën transmetohen këto role. Ata argumentojnë se ndarja e punës së papaguar në familje është përdorur, në shumë raste, si një tregues i sjelljes pak a shumë tradicionale. Ndërsa variablat si profesioni i nënës, pjesëmarrja e babait në punën e papaguar dhe niveli arsimor i prindërve shpjegojnë një pjesë të mirë të variacionit në rolet gjinore tek fëmijët, duke konfirmuar një efekt të rëndësishëm të imitimit të prindërve të tyre të sjelljeve gjinore.

Dex (2010) ngre shqetësimin nëse ndërhyrja e politikave për ndarjen e punës së papaguar mes burrave dhe grave është e mundur apo realiste. Nga pikëpamja e tregut të punës, Dex argumenton se politikat qeveritare që lehtësojnë bashkërendimin e punës dhe jetës familjare shpesh luajnë një rol vendimtar në pjesëmarrjen e grave në tregun e punës. Nga ana tjetër, Dex e pranon që këto politika kanë për qëllim të mbështesin të dy prindërit, por shpesh ato pa dashje përforcojnë rolin tradicional të grave si kujdestare, duke kontribuar kështu në pabarazi të vazhdueshme gjinore.

Gimenez-Nadal, Molina dhe Ortega (2017) studiovan lidhjen mes kohës që prindërit i kushtojnë punëve të shtëpisë dhe kohës që shpenzohet për punë shtëpie nga fëmijët e tyre. Ata gjetën korrelacione pozitive mes kohës së shpenzuar në punë të papaguar mes prindërve dhe fëmijëve, duke treguar që sa më shumë përfshihen prindërit në punë shtëpie, aq më shumë përfshihen dhe fëmijët e tyre në këto punë.

Dotti (2016) studioi masën në të cilën vajzat dhe djemtë mësojnë rolet gjinore në punët e shtëpisë në Itali. Ajo argumenton se, megjithëse si djemtë dhe vajzat kanë më shumë gjasa të angazhohen në punë shtëpie nëse babai i tyre bën punë shtëpie, efekti i përfshirjes së prindërve është më i fortë për djemtë sesa për vajzat. Për më tepër, Dotti shprehet se të mësuarit e bërjes së punëve të shtëpisë është një proces gjinor dhe si i tillë ka ndikime të rëndësishme në riprodhimin e pabarazive gjinore në Itali dhe kudo tjetër. Në analizat përshkruese dhe empirike që paraqiten në seksionet pasuese, të gjithë faktorët

e lartpërmendur janë marrë në konsideratë për të studiuar faktorët që ndikojnë në pjesëmarrjen e fëmijëve në aktivitete të punës së papaguar. Përveç këtyre aspekteve teorike, analiza shtrihet në rolin ndikues të gjyshërve që jetojnë në të njëjtën shtëpi me nipërit/mbesat e tyre, në formimin apo pengimin e krijimit të hendekut gjinor në punën e papaguar.

3. FËMIJËT DHE NDARJA E PUNËS SË PAPAGUAR

Anketa e Përdorimit të Kohës është një nga burimet më të përshtatshme për të studiuar pabarazitë gjinore në ndarjen e punës së paguar dhe të papaguar në terma sasiorë. Në Shqipëri, anketa e parë mbi përdorimin e kohës është kryer gjatë periudhës 2010-2011. Sipas rezultateve të APK-së, modelet e përdorimit të kohës tregojnë për pabarazi të mëdha gjinore sa i përket ndarjes së punëve të shtëpisë dhe punës së paguar. Modelet e përdorimit të kohës, sipas strukturës moshore të popullsisë, tregojnë se pabarazitë gjinore në përdorimin e kohës fillojnë që në moshë të vogël. Fëmijët e moshës 10 deri 14 vjeç shpenzojnë mesatarisht 53 minuta në ditë punë të papaguar, ndërsa fëmijët e moshës 15-17 shpenzojnë një orë e 14 minuta punë të papaguar, siç paraqitet në Tabelën 1.

Tabela 1: Angazhimi i fëmijëve në aktivitetet e punës së papaguar

	Grup moshë								
	10-14 vjeç			15-17 vjeç			10-17 vjeç		
	Djemtë	Vajzat	Gjithsej	Djemtë	Vajzat	Gjithsej	Djemtë	Vajzat	Gjithsej
Orët dhe minutat mesatare të shpenzuara në punë të papaguar në ditë									
Gjithsej	00:23	01:27	00:53	00:18	02:22	01:14	00:21	01:49	01:02
Zona urbane	00:19	00:57	00:39	00:05	01:47	01:00	00:13	01:19	00:48
Zona rurale	00:26	02:02	01:08	00:27	03:19	01:28	00:26	02:29	01:16
Përqindja e fëmijëve të angazhuar në punë të papaguar									
Gjithsej	30%	67%	48%	24%	81%	50%	27%	73%	49%
Zona urbane	28%	56%	43%	15%	77%	49%	23%	66%	45%
Zona rurale	31%	80%	53%	30%	88%	51%	31%	83%	52%

Burimi: Anketa e Përdorimit të Kohës në Shqipëri 2010-11, Llogaritje të autorit, të dhëna të peshuara


Sipas vlerësimeve të APK-së, 49% e fëmijëve të moshës 10-17 vjeç angazhohen në punët shtëpiake si pastrimi i shtëpisë, bërja e pazarit, kujdesi për fëmijët, kujdesi për të rriturit, kopshtari, larja e rrobave dhe hekurosja. Gjithashtu, ka diferenca të mëdha gjinore në përqindjet e fëmijëve që kryejnë punë si pastrimi i shtëpisë, larja e enëve, larja dhe hekurosja e rrobave. Nëse krahasojmë përqindjet e djemve dhe vajzave që angazhohen në punët shtëpiake, në mënyrë të dukshme, siç tregohet në Figurën 1, këto punë konsiderohen si detyrë e vajzave.

Në zonat rurale përqindja e djemve të moshës 15-17 vjeç të angazhuar në punë të papaguar është 30%, ndërsa përqindja e moshatarëve të tyre që jetojnë në zonat urbane dhe që angazhohen në

aktivitete të punës së papaguar është 15%. Për vajzat e moshës 10 deri 17 vjeç niveli i pjesëmarrjes në punët shtëpiake është më i lartë (73%) dhe bëhet akoma më i lartë për vajzat që jetojnë në zonat rurale (83%).

Prania e gjyshërve në të njëjtën shtëpi ka një ndikim të diskutueshëm mbi përfshirjen e fëmijëve në punët e papaguara/shtëpiake. Sipas të dhënave të censusit të vitit 2011, në Shqipëri një në dhjetë familje ka dy ose më shumë bërthama familjare. Nga pikëpamja tradicionale, gjyshërit janë shumë të dhënë pas nipërve dhe mbesave të tyre. Në Shqipëri shpeshherë dëgjon nga gjyshërit të thuhet shprehja “ai/ajo është mjalti i mjaltit”, shprehje që i referohet nipit/mbesës së tyre.

Figura 1: Përqindja e fëmijëve të moshës 10-17 vjeç të angazhuar në punë të papaguar, sipas llojit të aktivitetit dhe gjinisë




Burimi: Anketa e Përdorimit të Kohës në Shqipëri 2010-11, Llogaritje të autorit, të dhëna të peshuara

Gjyshërit janë të prirë që të transmetojnë normat sociale dhe kulturën tek nipërit dhe mbesat e tyre, dhe e ndiejnë këtë si një detyrë për t'u kujdesur për ta dhe për edukimin e tyre. Ekzistojnë kushte të forta bindëse për efektin që kanë gjyshërit në formimin ose në pengimin e krijimit të hendekut gjinor në punën e papaguar tek fëmijët. Prandaj është shumë e rëndësishme të studiohet roli që luajnë gjyshërit në pjesëmarrjen e nipërve/mbesave në punën e papaguar.

Figura 2 paraqet përqindjet e fëmijëve, prindërve dhe gjyshërve që kryejnë ndonjë formë të punës së papaguar sipas gjinisë dhe përbërjes së familjes. Nga figura vihet re se djemtë që kanë në shtëpi njërin apo të dy gjyshërit kanë një përqindje më të lartë angazhimi në punët shtëpiake, krahasuar me djemtë që jetojnë në familjet me një bërthamë familjare. Diferenca në pikë përqindje është 8,8.

sasia e kohës që shpenzojnë individët në këto aktivitete. Në Tabelën 2 paraqitet koha mesatare e shpenzuar në ditë në aktivitete të punës së papaguar, sipas gjinisë dhe llojit të familjes. Diferencat gjinore mbeten të larta në të gjithë brezat, edhe pse jo në të njëjtën madhësi. Megjithatë prania e gjyshërve në familjet me dy ose më shumë bërthama familjare nxit një pjesëmarrje më të madhe të djemve në punët e shtëpisë, prapë ndarja gjinore e punës së papaguar është shumë larg një ndarjeje egalitare, siç paraqitet në Figurën 3. Pjesëmarrja e baballarëve në punët shtëpiake është, po ashtu, më e ulët në familjet me dy apo më shumë bërthama familjare, krahasuar me baballarët e fëmijëve në familjet me një bërthamë. E njëjta gjë qëndron dhe për vajzat, të cilat angazhohen më pak në punë të papaguar nëse jetojnë me gjyshërit në të njëjtën shtëpi.

Figura 2: Përqindjet e fëmijëve që kryejnë aktivitete të punës së papaguar sipas gjinisë dhe statusit të banimit



Burimi: Anketa e Përdorimit të Kohës në Shqipëri 2010-11, Llogaritje të autorit, të dhëna të peshuara

Përfshirja e vajzave në punët shtëpiake është shumë më e lartë sesa e djemve në të gjitha llojet e familjeve, por, siç vihet re në Figurën 2, përqindja e vajzave që kryejnë punë të papaguar është më e ulët nëse ato jetojnë në familje të përbëra nga tre breza, madje akoma më e ulët sesa për vajzat që jetojnë me prindërit e tyre (me një diferencë prej 11 pikë përqindje). Një konkluzion i rëndësishëm nga këto gjetje është që gjyshërit jo vetëm që angazhohen në kryerjen e punëve shtëpiake, por gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në stimulimin e barazisë gjinore në ndarjen e punës së papaguar brenda familjes për nipërit dhe mbesat e tyre.

Koha mesatare e shpenzuar për kryerjen e ndonjë aktiviteti të punës së papaguar varet nga përqindja e njerëzve që angazhohen në këto punë dhe nga

Pjesëmarrja më e ulët, si e baballarëve ashtu dhe e vajzave, në familjet me dy ose më shumë bërthama familjare, ndikohet nga përfshirja e gjyshërve në bërjen e punëve shtëpiake.


Analiza e paraqitur deri në këtë pikë mat në terma sasiorë kohën e shpenzuar në punë të papaguar dhe përqindjen e individëve që kryejnë punë të papaguar. Në seksionin e mëpasshëm analiza zgjerohet në përcaktimin e faktorëve të mundshëm që ndikojnë në pjesëmarrjen e fëmijëve në punë të papaguar.

Tabela 2: Koha mesatare e shpenzuar në ditë në punë të papaguar, sipas gjinisë dhe përbërjes së familjes

	Gjinia	Familja me një bërthamë familjare	Familja me dy ose më shumë bërthama familjare	Gjithsej
	Në orë dhe minuta			
Fëmijët 10-17 vjeç	Djemtë	00:31	00:29	00:31
	Vajzat	02:27	02:31	02:28
Prindërit	Burra	00:51	00:28	00:47
	Gra	06:44	06:26	06:41
Gjyshërit	Burra	...	00:44	00:44
	Gra	...	02:51	02:51
Gjithsej	Burra	00:41	00:31	00:39
	Gra	05:02	04:10	04:50

Burimi: Anketa e Përdorimit të Kohës në Shqipëri 2010-11, Llogaritje të autorit, të dhëna të peshuara

Figura 3: Përqindjet e individëve që kryejnë aktivitete të punës së papaguar, sipas gjinisë dhe përbërjes së familjes



Burimi: Anketa e Përdorimit të Kohës në Shqipëri 2010-11, Llogaritje të autorit, të dhëna të peshuara

4. SPECIFIKIMI I MODELIT

Analiza empirike është bazuar në të dhënat e Anketës së Përdorimit të Kohës në Shqipëri, e cila është kryer nga INSTAT në vitet 2010-2011. APK është kryer në një zgjedhje probabilitare përfaqësuese prej 2.250 njësisish ekonomike familjare. Anketa mbulon popullsinë rezidente shqiptare në moshë 10 vjeç e lart. Në secilën nga familjet e zgjedhura, individëve të moshës 10 vjeç e lart iu kërkua të plotësonin dy ditare kohe. Informacioni për përdorimin e kohës u mbledh për intervale kohe 10 minutëshe të plotësuar nga vetë

individët në dy ditë të zgjedhura rastësisht (një në ditë jave dhe një në ditë fundjave).

Për analizën e paraqitur në këtë artikull janë përdorur të dhënat për fëmijët e moshës 10 deri 17 vjeç, si dhe të dhënat e prindërve dhe të gjyshërve të tyre. Përbërja e familjes është krijuar si variabël me dy kategori të mëdha: (1) njësi ekonomike familjare me një bërthamë familjare – përcaktuar si familje që përbëhet tërësisht vetëm nga një bërthamë (dy prindërit me fëmijët e tyre ose nënë e vetme me fëmijët e saj, ose baba i vetëm me fëmijët e tij); dhe (2) njësi ekonomike familjare me dy ose më shumë bërthama familjare të lidhura

me njëra-tjetrën - fëmijët që jetojnë me prindërit, të dy apo njërin prej tyre, dhe që jetojnë me të dy gjyshërit ose njërin prej tyre.

Këto kufizime japin një zgjedhje prej 954 fëmijësh, 1.200 prindër dhe 95 gjyshër. Puna e papaguar ose aktivitetet e kujdesit për punët shtëpiake në të gjithë artikullin i referohen aktivitetit kryesor dhe përfshin gatimin, larjen e enëve, pastrimin e shtëpisë, kopshtarinë, bërjen e pazarit, kujdesin për fëmijët, kujdesin për të moshuarit dhe aktivitete të tjera që lidhen me to.

Në analizë janë përfshirë dhe disa variabla që sipas studimeve të autorëve të tjerë, influencojnë ndarjen e roleve gjinore në punët shtëpiake. Literatura mbi ndarjen gjinore të punëve shtëpiake provon që statusi i aktivitetit ekonomik të prindërve ndikon në angazhimin e fëmijëve në aktivitete të punës së papaguar dhe ka një ndikim të rëndësishëm në formimin e roleve gjinore. Në këtë artikull, statusi i aktivitetit ekonomik të prindërve është kombinuar në katër kategori të mëdha: të dy prindërit janë në punësim; të dy prindërit nuk janë në punësim (janë ose të papunë ose ekonomikisht jo aktivë); babai është në punësim, por nëna jo; nëna është në punësim, por babai jo. Një tjetër variabël e derivuar për analizën empirike lidhet me pasjen e motrave dhe vëllezërve. Ky variabël është grupuar në dy kategori dhe merr vlerën 1 nëse fëmija ka motra/vëllezër të moshës 10 vjeç e lart dhe vlerën 0 nëse fëmija ka motra/vëllezër të moshës nën 10 vjeç. Për të eksploruar faktorët përcaktues të ndarjes së roleve gjinore për punën e papaguar tek fëmijët, është vlerësuar një model regresiv logit. Për një vektor të dhënë variablash të pavarur p , logit i një regresioni të shumëfishtë logjistik jepet nga ekuacioni:

$$g(x) = \beta_0 + \beta_1 x_1 + \dots + \sum_{j=1}^{k-1} \beta_{jl} D_{jl} + \beta_p x_p$$

rast në të cilin modeli i regresionit logistik është:

$$\Pr(child_{uw} = 1) = \pi(x) = \frac{e^{g(x)}}{1 + e^{g(x)}}, \text{ ku}$$

$$\begin{aligned} g(x) = & \beta_0 + \beta_1 Sex + \beta_2 AGE + \beta_3 siblings \\ & + \beta_4 Father_{uw} + \beta_5 GrandFath_{uw} \\ & + \beta_6 GrandMoth_{uw} + \beta_7 Fath_{empl} \\ & + \beta_8 Parents_{NE} + \beta_9 Moth_{empl} \\ & + \beta_{10} nucleus_{Both\ parents} + \beta_{11} nucleus_{one\ parent} \\ & + \beta_{12} settlement + \beta_{13} day \end{aligned}$$

Tabela 3: Përshkrimi i variablave të përfshirë në modelin regresiv logit

Ndryshoret	Përshkrimi	Kodimi
Child_{uw} (variabli i varur)	Pjesëmarrja e fëmijës në ndonjë aktivitet të punës së papaguar	0 – nuk kryen punë të papaguar 1 – kryen punë të papaguar
Sex	Gjinia e fëmijës	0 – djalë 1 – vajzë
Age	Mosha e fëmijës	
Siblings	Të pasurit motra/vëllezër	0 – ka motra/vëllezër të moshës deri në 10 vjeç 1 – ka motra/vëllezër të moshës mbi 10 vjeç
Father_{uw}	Pjesëmarrja e babait në ndonjë aktivitet të punës së papaguar	0 – nuk kryen punë të papaguar 1 – kryen punë të papaguar
GrandFath_{uw}	Pjesëmarrja e gjyshit në ndonjë aktivitet të punës së papaguar	0 – nuk kryen punë të papaguar 1 – kryen punë të papaguar
GranfMoth_{uw}	Pjesëmarrja e gjyshes në ndonjë aktivitet të punës së papaguar	0 – nuk kryen punë të papaguar 1 – kryen punë të papaguar
Father_{empl}	Babai është në punësim ndërsa nëna jo	1 – babai është në punësim ndërsa nëna jo 0 – ndryshe
Parents_{NE}	Të dy prindërit nuk janë në punësim	1 – të dy prindërit nuk punojnë 0 – ndryshe
Mother_{empl}	Nëna është në punësim ndërsa babai jo	1 – nëna është në punësim ndërsa babai jo 0 – ndryshe
nucleus_{Both parents}	Një bërthamë familjare (fëmija jeton me të dy prindërit)	1 – jeton me të dy prindërit (një bërthamë familjare) 0 – ndryshe
nucleus_{one parent}	Një bërthamë familjare (fëmija jeton me njërin prej prindërve)	1 – jeton me njërin prej prindërve (një bërthamë familjare) 0 – ndryshe (dy ose më shumë bërthama familjare)
settlement	Zona e banimit	1 – zona urbane 2 – zona rurale
day	Lloji i ditës	1 – ditë jave 2 – ditë fundjave

5. REZULTATET EMPIRIKE

Tabela 4 paraqet rezultatet e vlerësimit për raportet e shanseve (odds ratios) të marra nga modeli logit, të cilat shpjegojnë probabilitetin që një fëmijë të angazhohet në bërjen e ndonjë aktiviteti të punës së papaguar.

Analiza përshkruese tregoi që ka një hendek gjinor në përfshirjen e fëmijëve në punë të papaguar dhe kjo konfirmohet edhe nga vlerësimit e modelit logit, të cilat tregojnë që vajzat përfshihen në

mënyrë të rëndësishme në punët e shtëpisë. Probabiliteti që një vajzë të kryejë punë shtëpiake është 7,4 herë më i lartë sesa probabiliteti për djemtë. Ndarja e punës së papaguar është shumë gjinore dhe ka një shpërndarje shumë të anuar. Pasja e motrave dhe vëllezërve konsiderohet si një faktor i rëndësishëm që influencon përfshirjen e fëmijëve në punë të papaguar (Solaz dhe Wolf, 2015). Alvares dhe Miles (2008) argumentojnë se prania e motrave dhe vëllezërve mund të ndikojë dhe transmetimin e roleve gjinore. Rezultatet e

Tabela 4: Vlerësimet për raportet e shanseve për pjesëmarrjen e fëmijëve në aktivitete të punës së papaguar

Ndryshoret	Raporti i shanseve Odd ratios	Gabimi standard (Bootstrap)	P > z
Sex Kat. referuese: djemtë	7.382*	0.926	0.000
Age	1.116*	0.030	0.000
Siblings Kat. referuese: ka motra/vëllezër të moshës deri në 10 vjeç	0.644*	0.066	0.000
Father_{uw}	1.420*	0.168	0.003
GrandFath_{uw}	2.175	0.982	0.085
GranfMoth_{uw}	0.792	0.282	0.512
Father_{empl} Kat. referuese: të dy prindërit në punësim	0.725*	0.089	0.009
Parents_{NE} Kat. referuese: të dy prindërit në punësim	0.805	0.153	0.253
Mother_{empl} Kat. referuese: të dy prindërit në punësim	1.083	0.273	0.753
nucleus_{Both parents} Kat. referuese: dy ose më shumë bërthama familjare	1.027	0.251	0.914
nucleus_{one parent} Kat. referuese: dy ose më shumë bërthama familjare	1.234	0.414	0.531
Settlement Kat. referuese: zona urbane	1.913*	0.187	0.000
Day Kat. referuese: ditë jave	1.688*	0.176	0.000
Konstantja	0.070	0.031	0.000

*p= 0.05

Numri i vrojtimit = 1764

Wald chi2(12) = 492.58, Log likelihood = -991.315

Prob > chi2 = 0.0000

Pseudo R2 = 0.1816

modelit logit tregojnë se fëmijët që kanë motra ose vëllezër më të mëdhenj, të moshës mbi 10 vjeç, kanë më pak gjasa që të përfshihen në punët shtëpiake, krahasuar me fëmijët që kanë motra dhe vëllezër të moshës deri në 10 vjeç. Ky rezultat është i pritshëm pasi zakonisht motrat/vëllezërit më të rritur kujdesen për motrat/vëllezërit më të vegjël.

Shumica e studimeve empirike konfirmojnë që pjesëmarrja e prindërve në punët e shtëpisë ka një ndikim statistikisht të rëndësishëm (Gimenez-Nadal, Molina dhe Zhu, 2014). Rezultatet e modelit të vlerësuar logit tregojnë që përfshirja e babait në kryerjen e ndonjë aktiviteti të punës së papaguar në shtëpi ka një efekt pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm në angazhimin e fëmijëve në punët shtëpiake. Kështu, gjasat e pjesëmarrjes në aktivitete të punës së papaguar janë 1,4 herë më të mëdha për një fëmijë, babai i të cilit kryen ndonjë punë shtëpiake. Kjo gjetje mbështet hipotezën e modelit të rolit të prindit (Sevilla, Gimenez-Nadal, dhe Fernandez, 2010), ku pjesëmarrja e babait në punët e papaguara ndikon në transmetimin e roleve gjinore.

Duke konfirmuar gjetjet e dhëna në seksionin 3, rezulton që mosha ka efekt pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm në pjesëmarrjen e fëmijëve në punë të papaguar. Fëmijët duke u rritur përfshihen më shumë në kryerjen e aktiviteteve të punës së papaguar. Duke konsideruar statusin e aktivitetit ekonomik të prindërve, gjasat që një fëmijë të kryejë punë të papaguar ulen për fëmijët, baballarët e të cilëve janë të punësuar ndërsa nënat janë jo në punësim.

Rezultatet e vlerësuara tregojnë për një lidhje statistikisht të parëndësishme mes pjesëmarrjes së fëmijëve në punë të papaguar dhe pjesëmarrjes së gjyshërve të tyre. Kufizimet e mundshme të kësaj gjetjeje lidhen me numrin e familjeve të vrojtuar me dy ose më shumë bërthama familjare dhe me faktin që përqindja e familjeve me një bërthamë familjare është shumë më e madhe. Vlerësimet e paraqitura në Tabelën 4 tregojnë se gjasat që një fëmijë të kryejë punë të papaguar janë dy herë më të larta për një fëmijë që jeton në zonat rurale, krahasuar me një fëmijë që jeton në zonat urbane. Gjasat që fëmijët të kryejnë punë të papaguar janë më të larta në ditët e fundjavës.

6. KONKLUZIONE

Ky artikull paraqet studimin e përcaktuesve të ndarjes gjinore të punës së papaguar tek fëmijët e moshës 10-17 vjeç në Shqipëri, duke përdorur të dhënat e APK-së dhe nëpërmjet vlerësimit të një modeli logit.

Pabarazia gjinore në ndarjen e punës së papaguar fillon që në moshë të re, ndërsa analiza empirike tregon që prania e gjyshërve që jetojnë në të njëjtën familje me nipërit dhe mbesat e tyre nxit një pjesëmarrje më të madhe të djemve në punët e shtëpisë. Por pavarësisht kësaj, ndarja e punës së papaguar në Shqipëri është shumë larg ndarjes egalitare.

Duke krahasuar shkallët e pjesëmarrjes së djemve dhe vajzave në punët shtëpiake, provohet në mënyrë të qartë që në Shqipëri këto aktivitete konsiderohen si detyrë e vajzave. Ndarja e aktiviteteve të punës së papaguar tregon për një shpërndarje shumë të anuar në aspektin gjinor. Probabiliteti që një vajzë të angazhohet në bërjen e punëve shtëpiake është 7,4 herë më e lartë sesa për një djalë.

Pjesëmarrja e babait në bërjen e punëve shtëpiake ka një efekt statistikisht të rëndësishëm pozitiv mbi përfshirjen e fëmijëve në aktivitete të punës së papaguar. Kështu, raporti i shanseve për pjesëmarrjen e fëmijëve në punë të papaguar është 1,4 herë më e lartë nëse babi bën punë shtëpie. Zona e banimit është një tjetër faktor që ka një ndikim statistikisht të rëndësishëm në angazhimin e fëmijëve në aktivitete të punës së papaguar. Kështu, raporti i shanseve që një fëmijë të kryejë punë të papaguar është më i lartë për një fëmijë që jeton në zonat rurale, sesa për një fëmijë që jeton në zonat urbane. Lloji i ditës përcakton pjesëmarrjen e fëmijëve në punë të papaguar, ku gjasat janë më të mëdha në ditët e fundjavës.

BIBLIOGRAFI

Alesina, Alberto & Giuliano, Paola, 2007. "The Power of the Family," IZA Discussion Papers 2750, Institute for the Study of Labor (IZA).

Almudena Sevilla-Sanz, Jose Ignacio Gimenez-Nadal & Cristina Fernández (2010) "Gender Roles and the Division of Unpaid Work in Spanish Households", *Feminist Economics*, 16:4, 137-184
DOI: 10.1080/13545701.2010.531197

Alvarez, B. and D. Miles (2008) "Intergenerational transmission of gender roles: An empirical analysis through housework".

Bajraba, K, (2014), "Albania, Perspectives and Perceptions of the Mediterranean", The Anna Lindh Report 2014

Bianchi, S. M. (2006). Mothers and daughters "do," fathers "don't do" family: gender and generational bonds. *Journal of Marriage and Family* 68 (4), 812-816.

Cosp, M.A and Roman, J.G. (2014), "Intergenerational transmission of gender roles in the household", *Revista Catalana de Sociologia*, (29), 35-47.

Dex, S. (2010), "Can State Policies Produce Equality in Housework?", in Treas, J. and S. Drobic (eds.), *Dividing the Domestic*, Stanford University Press, Stanford.

Dotti Sani, G. M. (2016), "Undoing Gender in Housework? Participation in Domestic Chores by Italian Fathers and Children of Different Ages" (*Sex Roles* (2016) 74: 411. <https://doi.org/10.1007/s11199-016-0585-2>)

Fernandez, C. and A. Sevilla-Sanz (2006) "Social norms and household time allocation", *Economics, Series Working Papers* 291, University of Oxford, Department of Economics.

INSTAT (2011) Albania Time Use Survey 2010-11

Elezi, P. (2017) "Unpaid work in Albania and the inheritance of gender roles", working paper presented in the Conference of European Statisticians on "Measuring time use and valuing unpaid work", Belgrade 2017.

Gimenez-Nadal, J.I., J.A. Molina and R. Ortega (2017). "Like my parents at home? Gender differences in childrens' housework in Germany and Spain" *Empirical Economics* 52(4): 1143-1179.

Gimenez-Nadal, J.I., J.A. Molina and Y. Zhu (2014). "Intergenerational Mobility of Housework Time in the United Kingdom". *Review of Economics of the Household* (DOI: 10.1007/s11150-017-9374-0).